

E RËNDËSISHME!

Personat e moshës 65 vjeç e sipër mund ta marrin vaksinën kundër gripit falas!

Vaksinimi kundër gripit nuk jep 100% siguri që i vaksinuari nuk do sëmuret nga gripi, por edhe nëse sëmuret, gripi do të jetë në formë më të lehtë dhe rreziku i komplikimeve, hospitalizimit dhe vdekjes do të reduktohet ndjeshëm.

Nuk rekomandohet përdorimi i barnave për parandalimin e gripit!



CAKTONI AFAT VAKSINIMI PËRMES UEB PLATFORMËS!



Terminet për vakcina falas bëhen përmes ueb-faqes:

www.vakcinacija.mk

Duke plotësuar formularin, ju regjistroheni për vaksinim, direkt në sistemin Moj Termin. Me anë të një mesazhi SMS, do të merrni informacion për datën dhe orën e saktë të vaksinimit në pikën që zgjidhni gjatë regjistrimit.

Përveç kësaj, ju mund të merrni një vaksinë komerciale të gripit sezonal në Qendrën tuaj më të afërt të Shëndetit Publik pa një paraqitje paraprake.

NËSE JENI 65+ A E DINI SE GRIPI APO INFLUENCA mund të jetë një sëmundje serioze, veçanërisht për të moshuarit?

**Personat në
moshën 65 vjeç
e sipër janë të
kanosur më së
shumti nga një
sëmundje ë
rëndë.**



FAKT: Njerëzit mbi 65 vjeç janë në rrezik më të lartë për të zhvilluar komplikime serioze nga gripin, krahasuar me të rinjtë e shëndetshëm.

Ky rrezik është pjesërisht për shkak të:

- ◆ ndryshimeve në sistemin imunitar që ndodhin me rritjen e moshës.
- ◆ Personat mbi 65 vjeç që kanë sëmundje kronike kanë një faktor shtesë që i vendos ata në rrezik më të madh nga komplikimet serioze të gripit.

Është vlerësuar se midis 70 dhe 85 përqind e vdekjeve që kanë të bëjnë me gripin sezonal ndodhin tek personat 65 vjeç e sipër, dhe midis 50 dhe 70 përqind e hospitalizimeve të lidhura me gripin sezonal ndodhin tek personat në këtë grupmoshë (Burimi CDC)

FAKT: Vaksinimi i gripit sezonal është mënyra më e mirë për të reduktuar rrezikun për ta fituar gripin dhe komplikimet e mundshme serioze.

Vaksinimi zvogëlon rrezikun e infektimit me grip dhe zhvillimin e komplikimeve serioze që mund të rezultojnë në hospitalizim apo edhe vdekje tek të moshuarit.

Vaksina e gripit mbron nga viruset e gripit që do të jenë dominues gjatë sezonit të ardhshëm.

Vaksinat e gripit janë të sigurt dhe nuk shkaktojnë grip.

Vaksinimi vjetor i gripit sezonal ndihmon në fitimin e mbrojtjes më të mirë të mundshme kundër gripit.

FAKT: Efektet anësore të vaksinave kundër gripit janë të lehta në krahasim me pasojat potencialisht serioze të infeksionit me virusin e gripit.

Pas marrjes së vaksinës kundër gripit, mund të keni disa efekte anësore që janë zakonisht të lehta dhe përfshijnë dhimbje, ndjeshmëri, skuqje dhe/ose ënjtje në vendin e injektimit të vaksinës. Ndonjëherë mund të keni dhimbje koke, dhimbje muskujsh, ethe dhe përzierje ose të ndjeheni të lodhur.